



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
**OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA**

---

P.nr 967/17

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P.gjyqtari Ahmet Rexhaj me sekretaren juridike Lindmire Begolli ,në lëndën penale kundër të pandehurit B. Z nga P, e duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore ne Pejë -Departamenti i Përgjithshëm PP-II- 1752/17 të dt. 21.09.2017 , për vepër penale mbajtja nën pronësi kontrolle ose posedimi të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së , pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë te mbajtur në praninë e të pandehurit dhe të Prokurori i shtetit Ardian Hajdaraj me dt.17.10.2017, ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri B.Z i lindur me ..... , i biri i H dhe nga nëna Gj e gjinisë I , kam të kryer shkollën fillorë , jetoj në f. Strellci i Ultë K.Deqan , me prof. i pa pune, i gjendjes së dobët ekonomike, i identif. lenj. .... , shtetas i Republikës së Kosovës , mbrohet ne liri .

Me dt. 03.07.2017 rreth orës 16:15 min. ne P. ne rr .... ne parkingun e autobusëve pikërisht para lokalit “ Kajot “ duke shkelur ligjin e zbatueshëm lidhur me arme ka mbajtur ne posedim dhe kontroll një pistolet ..... në atë mënyrë që gjatë bastisjes së kryer nga ana e policisë në veturën ....., pronë e dëshmitarit A.Q të njëjtit prapa ulëses se parme te pasagjerit gjejnë armen e lartcekur te cilën arme I pandehuri ka pranuar se është e tij.

-me çka ka kryer vepre penale: mbajtja nën pronësi kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par 1 te KPRK-së.

Prandaj gjykata të pandehurit konform nenit 41, 42, 43,46 49, dhe nenit 374 par.1 të KPRK-së.

**GJYKON :**

Me dënim me gjobë në lartësi prej (pesëqindë) 500 euro, e të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar që ta paguaj brenda 3 muajsh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë .

Nëse i pandehuri gjobën në fjalë nuk e paguan brenda këtij afati – dënimi me gjobë automatikisht do të shndërrohet në dënim me burg – duke llogaritur 20 euro = 1 ditë burg !.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 50 euro – ne afat prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë .

Të pandehurit konform nenit 62 par 1 dhe 2 pika 2.6 I shqiptohet dënimi plotësues marrja dhe konfiskimi I një arme , arme pistoletë e llojit .....

#### A r s y e t i m

PROKURORIA THEMELORE ne Peje , me dt. 21.09.17 kundër të pandehurit B.Z nga P , kanë ngritur aktakuzë PP-II- 1752/17 për vepër penale, për vepër penale mbajtja nën pronësi kontrolle ose posedimi të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit fillestar të pandehurin ta shpallë fajtor të dënoj sipas ligjit, dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimi përkatësisht të mos pranimi të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari –e ka aprovuar pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit , i bindur se pranim fajësisë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë -e ka pranuar konform nenit 248 par.1, te KPPRK-së.

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloj ne marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç’rast pati përsyshë të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanat rënduese ne rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur ,kurse nga ato lehtësuese ka çmuar pranimin e singertë te fajësisë pendimin e thelle për kryerjen e veprës , qëndrimin korrekt ne gjykatë , pa dënueshmërinë e mëparshme , dhe kësisoji gjyqtari mendon dhe është i bindur se edhe me nje vendim si ne diapozitiv te aktgjykimit ndaj te pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë nenin 41 te KPRK-së,

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe pushalli gjyqësor është mare konform nenit 450 te KPPRK-së,

Me sa u tha me lart konform nenit 365 te KPPRK-së u vendos si me lartë.

NGA GJYKATA THEMELORE NE PEJE Departamenti i Përgjithshëm me dt. 17.10.2017.

Sekretarja juridike  
Lindmire Begolli

GJYQTARI  
Ahmet Rexhaj

#### KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi lejohet  
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga  
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë  
E përmes kësaj Gjykate .

**APROVOHET** propozimi i të pandehurit për heqje dorë nga kërkesa për hudhje të akuzës dhe kundërshtimit të provave, konform nenit 249 dhe 250 të KPP-së

**ANULOHET** shqyrtimi i dytë dhe të gjitha provat e paraqitura nga prokurori të merren ligjërisht të pranueshme dhe gjykata nuk ka gjetur asnjë arsye ligjore për hudhje të aktakuzës konform nenit 250 të KPP-së

**CAKTOHET** shqyrtimi gjyqësor me dt. 11.4.2017, në orën 10:00, palëve prezent iu komunikua verbalisht kjo do tu shërbejë si ftesë në mënyrë të rregullt, ndërsa të dëmtuarit dhe dëshmitarit, ftesa do ti dërgohet në mënyrë të rregullt.

Shqyrtimi fillestar përfundoi në orën 13:50.

Palët prezent e nënshkruajnë procesverbalin pa vërejtje.

Prokurori i shtetit

I pandehuri

---

---

Vë r t e t o j n ë

Sekretarja juridike,

Gj y q t a r i,